



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT



**Mekanizmi Kombëtarë për Parandalimin e Torturës**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201302517/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2013

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i kushteve të trajtimit të të denuarve dhe të paraburgosurve në I.E.V.Penale Fush-Krujë.*

**Drejtuar:** **Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve  
Z. Artur Zoto**

**TIRANË**

**Drejtorit të I.E.V.Penale Fush-Krujë  
Z. Ramazan Hoxha**

**Fush-Krujë**

**Të nderuar Zotërinj,**

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kreu një inspektim të përgjithshëm në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fush-Krujë më dt.17.10.2013. Në përfundim të këtij inspektimi, pasi u njoh me të gjithë konstatimet e grupit inspektues, si dhe me problematikat e ngritura nga ana e të denuarve dhe paraburgosurve, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si vijon:

Me urdhër nr. 329, datë 15/01/2009, "Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale", të ndryshuar, "Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fushë-Krujë kategorizohet burg i sigurisë së lartë, me një seksion burg i sigurisë së zakonshme dhe një seksion paraburgimi". Kapaciteti maksimal zyrtar i kësaj I.E.V.P.-je është 312 persona. Në kohën e vizitës, institucioni strehonte 397 persona, prej të cilëve 47 të paraburgosur.

## ***Shënime paraprake***

Në përputhje me procedurën e zhvillimit të monitorimit, grupi monitorues zhvilloi fillimisht takimin me drejtuesin e institucionit. Grupi monitorues informoi drejtorin në lidhje me qëllimin e vizitës monitoruese të MKPT. Nga ana e drejtuesit të institucionit, cili edhe pse i ri në detyrë, u shpreh i gatshëm për të realizuar të gjitha kërkesat e grupit monitorues. Sikurse edhe u citua më lart, sipas informacionit paraprak të marrë nga drejtuesi i institucionit, në I.E.V.P.-në Fushë-Krujë, në momentin e vizitës monitoruese strehoheshin dhe 47 persona të paraburgosur, 8 prej të cileve ishin të moshës 18-21 vjeçare dhe 350 të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykatat.

Institucioni kishte një seksion të veçantë për të paraburgosurit me kapacitet për 30 persona, të ndarë në dy sektorë, përkatësisht sektori 3 me dhjetë dhoma, dhe sektori 4 me 7 dhoma. Institucioni strehonte në kohën e vizitës 8 të paraburgosur të grupmoshës 18-21 vjeçare. Persona që të kishin marrë vendimin e gjykatës, duke ndërruar statusin nga të paraburgosur në të burgosur dhe që duhet të transferoheshin në institucion për të vuajtur dënimin nuk kishte. Të paraburgosurit, strehoheshin kryesisht në dhoma me dy shtretër, por për shkak të mbipopullimit në disa raste në dhomat me dy shtreter strehoheshin 3-4 vetë.

Të paraburgosurit e grupmoshës 18-21 vjeçare nuk ishin të sistemuar në seksion më vehte, por ata strehoheshin në dhoma së bashku me të paraburgosurit e rritur. Sipas informacionit të marrë, në institucion në kohën e monitorimit nuk figuronin të paraburgosur të punësuar. Lidhur me ambientet e tjera në regjim, institucioni kishte një dhomë observimi dhe një dhomë veçimi nga aktivitetet e përbashkëta. Në këto dhoma, në kohën e monitorimit nuk strehoheshin të paraburgosur, përveç se një personi i cili erdhi në momentin e vizitës së grupit monitorues dhe u strehua në dhomën e observimit sipas procedurës.

Vizita monitoruese pranë I.E.V.P. Fushë-Krujë u zhvillua në një frymë të mirë bashkëpunimi. Nga ana e drejtuesit të Institucionit u ofrua mundësia për të patur akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë ambientet që ekspertët do të monitoronin. Objektivi kryesor i kësaj vizite monitoruese ishin kushtet dhe trajtimi i të burgosurve dhe të paraburgosurve.

### ***1. Trajtimi***

Grupi i monitorimit pati si objektiv mbledhjen e informacionit lidhur me trajtimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve, në identifikimin e rasteve të përdorimit të torturës, trajtimit degradues e diskriminues, përdorimit të forcës fizike përtej kufijve të parashikuar me akte normative apo të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, si dhe të rasteve të marrjes së masave disiplinore të veçimit nga aktivitetet e përbashkëta. Lidhur me këtë fakt, nga informacioni i marrë nga bisedimi në grup dhe në privatësi me vetë të dënuarit dhe të paraburgosurit, grupi monitorues nuk konstatoi ndonjë rast torture, trajtimi degradues e diskriminues, përdorimi të tepruar të forcës apo dhunë psikologjike nga ana e punonjësve të kësaj I.E.V.P.-je ndaj të burgosurve dhe paraburgosurve, përveç një rasti të para disa muajve, për të cilin Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kishte marrë masë ndëshkimore për punonjës të me

iniciale I.P, masë që u konfirmua nga i paraburgosuri i keqtrajtuar me inicialet F.K.

## **2. Masat mbrojtëse**

Në përputhje me standartet e përgjithshme të Drejtave të Njeriut, grupi monitorues kreu gjithashtu një inspektim të jashtëm në Institucion, me qëllim vlerësimin e kushteve dhe trajtimin e personave të burgosur dhe të paraburgosur. Ekspertët morën informacion në lidhje me pritjen e të burgosurve/paraburgosurve në institucion dhe funksionimin e Komisionit të Pritjes, si dhe në lidhje me plotësimin e regjistrave e dosjeve personale të tyre. Nga biseda me Drejtuesin e Institucionit, grupi monitorues u informua se procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte.

Grupi i monitorimit konstatoi se kategoria e grupmohës së të paraburgosurve 18-21 vjeçare nuk ishin të sistemuar në seksion më vehte, por banonin në dhoma së bashku me të paraburgosurit e rritur. Gjithashtu edhe aktivitetet e përbashkëta kjo grupmohë i kryente së bashku me grupmohën e rritur. Nga kontakti me vetë të paraburgosurit e kategorisë 18-21 vjeçare, ekspertët u bënë me dije se banimi me të rriturit ishte zgjedhje e tyre për shkak të lidhjeve shoqërore që kishin me bashkëjetuesit, zgjedhje për të cilën kishte rënë dakort edhe drejtorja e institucionit.

## **3. Kushtet materiale**

Grupi i monitorimit mblodhi informacion dhe monitoroi aspektet e ndryshme të kushteve materiale të të burgosurve/paraburgosurve në institucion dhe u përqëndrua kryesisht në këto aspekte: ushqimi dhe shërbimi në kohe të vakteve, ndriçimi, ajrimi, higjiena personale, kushtet sanitare, veshja, mbipopullimi, kushtet e banimit, etj.. Ushqimi në institucion shërbehet në 3 vakte në kohë të caktuara dhe të shpërndara proporcionalisht gjatë ditës. Nga ana e të paraburgosurve që konsumonin ushqimin e institucionit pati vërejtje për cilësinë dhe varietetin e ushqimit. U monitorua kuzhina, higjiena, kushtet e përgatitjes së vakteve, dokumentacioni përkatës lidhur me menunë ditore e javore, ruajtja e kampioneve në dhoma frigoriferike.

Këto kritere u gjetën konformë standarteve ligjore. Ushqimi për të burgosurit/paraburgosurit diabetikë nuk gatuhej nga institucioni, por atyre u jepej menuja e ushqimit, të cilin e gatuanin vetë. Ekspertët konstatuan një formë shpërndarje të ushqimeve të caktuara si: qumësht në kuti 1 litërshe, apo vezë të pagatuara, që sipas personelit të institucionit kjo gjë kërkohej nga vetë të burgosurit/paraburgosurit. Ekspertët konstatuan që jo të gjithë personat në I.E.V.P. kishin frigorifer në dhomat e tyre. Me qëllimin për të shmangur mundësinë e ndonjë helmimi apo sëmundjeje tjetër, shqetesimin e tyre për këtë formë shpërndarje të këtyre ushqimeve ia përcollëm dhe Drejtorit të institucionit.

Institucioni i Fushë-Krujës nuk ishte i pajisur me sistem ventilimi. Ajrosja në institucion realizohej në mënyrë natyrale, nëpërmjet dritareve, me masa brenda kërkesave të standartit. Një problem i konstatuar nga grupi monitorues ishte mungesa e ngrohjes për stinën e dimrit, problem i cili ekzistonte prej

kohësh në këtë institucion. Në institucion ekzistonte një impiant ngrohjeje, por ishte i paaktivizuar ende për këtë vit. Grupi i monitorimit monitoroi ambientet e banimit në regjimin e brendshëm. Dhomat e banimit, të cilat ishin standart dhe të pajisura me nyje sanitare dhe lavaman, kishin përafërsisht këto përmasa: 4.5m\*2.5m\*2.8m.

Duke qënë se në kohën e monitorimit në institucion u konstatua mbipopullim, në dhomat e parashikuara për dy persona flinin 3 apo 4 persona. Kjo gjë sillte shkeljen e standartit të sipërfaqes së banimit për person (3.75 m<sup>2</sup> nga 4 m<sup>2</sup> që parashikohet në ligj). U konstatua gjithashtu se, personi i tretë apo i katërt si në sektorin 3 dhoma 4, 5,10; sektori 4 dhoma 7,etj, flinte në tokë. Shtresat për fjetje ishin garantuar nga institucioni. Gjatë momentit të vizitës ambientet e banimit u gjetën higjenikisht në rregull. Në dhoma mungonin karriget e dollapet e rrobave, dhe këto të fundit mbaheshin nga të paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve.

Një fakt i tillë i konstatuar nga ana e grupit monitorues është në kundërshtim me kërkesat ligjore ndërkombëtare<sup>1</sup>. Gjatë vizitës në dhomat e të burgosurve/paraburgosurve, u konstatua se uji i rrjedhshëm vazhdonte të ishte me orar të reduktuar: 06.30-07.30; 09.30-10.30; 14.30-15.30; 18.30-20.30. Ky fakt mund të shërbejë si premisë për mosrespektimin e higjenës personale të të burgosurve/paraburgosurve dhe si rrjedhojë nuk plotëson kërkesat e Rregullave Minimale të Trajtimit të të Burgosurve<sup>2</sup>, ashtu si edhe kërkesat e Rregullave Europiane të Burgut<sup>3</sup>. Grupi i monitorimit monitoroi në vend ambientet e përbashkëta të dusheve.

Edhe pse ambientet dhe pajisjet e dusheve ishin pothuajse të reja, duke u nisur si nga bisedat me të paraburgosurit, ashtu edhe nga konstatimi në vend i grupit monitorues, apo edhe gjatë bisedës me drejtuesin e institucionit, u arrit në konkluzionin se ato nuk funksiononin në këtë I.E.V.P. Edhe lavanderia, edhe pse ishte në gjendje funksionale, nuk ishte në shërbim të të burgosurve/paraburgosurve. Rrobat e tyre ata i lanin vetë apo nga familjarët e tyre. Një tjetër problem i konstatuar nga ana e grupit monitorues ishte prania e furrtareve(insekte) në dhomat e të burgosurve/ paraburgosurve.

Edhe pse ishte tentuar disa herë nga ana e institucionit për ta zgjidhur këtë problem, sërish situata nuk kishte ndryshuar dhe insektet ishin të pranishme. Përsa i përket pajisjes së rregullt të të burgosurve/paraburgosurve me produkte të higjenës së përbashkët dhe të asaj personale si detergjentë, qese pleherash, shampo, e artikuj të tjerë, institucioni nuk realizonte në mënyrë të plotë dhe sistematike një detyrim të tillë. Të burgosurit/paraburgosurit pajiseshin me këto artikuj kryesisht nga familjarët. Në këtë pikë I.E.V.P. Fushë-Krujë, rezultoi me shkelje të këtij standarti, garantuar nga legjislacioni vendas në fuqi<sup>4</sup>.

---

<sup>1</sup> Rregulla 22 e Regullave Europiane të Burgjeve

<sup>2</sup> Rregulla 12 Rregullave Minimale të Trajtimit të të Burgosurve (ERM)

<sup>3</sup> Rregulla 17 e Regullave Europiane të Burgjeve

<sup>4</sup> Neni 30 pika 2, e 31 pika 2 e Vendimit Nr. 303, datë 25.3.2009 « Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve »

#### **4. Regjimi dhe aktivitetet**

Grupi i monitorimit u informua lidhur me respektimin e së drejtës së të burgosurve/paraburgosurve për të patur kontakte me familjarët dhe monitoroi dhomat e takimit. Këto të fundit ishin konform parametrave të kërkuar. Ambienti i takimit ishte i ndarë me xham dhe pjesa e familjarëve dhe e të burgosurve mund të komunikonin lirshëm, ulur në stola, gjithmonë nën vëzhgimin në distancë të punonjësit të policisë. Respektohej privatësia. Takimi zgjaste rreth 30 minuta. Nga biseda me të burgosurit mbi këtë temë nuk pati ndonjë ankesë. Por ekspertët nga monitorimi në vend konstatuan se ambienti i takimit nuk ishte i përshtatshëm për takime me familjarë të mitur, si edhe në muajt e ftohtë të vitit në këtë ambient mungonte ngrohja.

Nuk kishte më shqetësime nga të burgosurit për sa i takon numrit të telefonatave që ata mund të kryenin gjatë një muaji. Sipas informacionit të marrë, në institucion, në kohën e monitorimit nuk figuronin të paraburgosur të punësuar. Kategoria e grupmohës së të paraburgosurve 18-21 vjeçare nuk ishin të sistemuar në seksion më vehte, por banonin në dhoma së bashku me të paraburgosurit e rritur. Gjithashtu edhe aktivitetet e përbashkëta kjo grupmohë i kryente së bashku me grupmohën e rritur. Respektohej e drejta e të burgosurve/paraburgosurve për ajrim në institucion.

Në një rast u konstatua që një person që vuante nga astma dhe merrte mjekim, edhe pse i ishte rekomanduar nga mjekja e institucionit ajrim shtesë, atij nuk i ishte mundësuar ky ajrim. Institucioni kishte bibliotekë dhe ambient leximi, si dhe ekzistonte mundësia që të burgosurit/paraburgosurit të merrnin libra për t'i lexuar në dhomat e tyre. E drejta e besimit respektohej dhe në institucion kishte hapësira të veçanta për ushtrimin e fesë, e cila realizohej në ditët e caktuara. Aktivitetet sportive, përveç lojërave të tavolinës, për të burgosurit/paraburgosurit e interesuar, konsistonin edhe në kalçeto dy herë në javë.

Sektori i shërbimit të kujdesit social vazhdonte të kishte të njëjtën organikë prej dhjetë punonjësish, prej të cilëve:

- një përgjegjës sektori,
- pesë specialistë edukimi,
- një punonjës social,
- dy psikologë
- një specialist biblioteke.

-

Ekspertja psikologe, pasi realizoi takimet me të paraburgosurit në ambientet e tyre, kontaktoi me përgjegjësen e sektorit të kujdesit social si dhe dy edukatorë për të marrë informacione shtesë mbi nevojat e punonjësve të këtij shërbimi, si dhe vlerësoi dokumentacionet që mbështesnin punën e kryer. Nga këto biseda si dhe nga rezultatet e vlerësimit të dosjeve, ishin marrë në konsideratë një sërë rekomandimesh të cilat ishin dhënë nga MKPT në raportet e monitorimeve të mëparshme. Kurset e formimit profesional më parë vlerësoheshin si ekskluzivitet për të dënuarit, pasi të paraburgosurit shiheshin si grupim me mobilitet më të lartë.

Kështu në muajin Shkurt të vitit 2013 ishte hartuar një plan masash për zbatimin e planit të veprimit për plotësimin e rekomandimeve, ku ndër të tjera

parashikohej marrja e masave në vazhdimësi për sensibilizimin, orientimin, dhe pjesëmarrjen e të paraburgosurve në kurse të formimit profesional dhe programe arsimore. Në zbatim të këtij plani masash më datë 22.02.2013 ishte planifikuar dhe kishte filluar nga zbatimi kursi i formimit profesional në kompjuter për të paraburgosurit e interesuar (11 persona të grupmoshës 18-21 vjeçare). Gjithashtu një ditë më vonë më datë 23.02.2013 kishin filluar programet arsimore.

Gjithsesi, kurset e ofruara kishin përfunduar, dhe aktualisht këto kurse nuk ofroheshin për të paraburgosurit. Sipas shefes së sektorit, kurset planifikoheshin për të gjithë I.E.V.P.-në, ndaj si të tilla ato realizoheshin kur ishte e mundur. Për sa i përket temave sociale, nda dokumentacioni i shqyrtuar rezultonte se ato ishin kryer në përputhje me direktivat e DPBSH-së. Nuk kryheshin këshillime në grup, ndërsa këshillimet individuale kryheshin kur ishte e mundur në dhomat e të burgosurve/paraburgosurve dhe në ajrosje. Nga shqyrtimi i dosjeve psiko-sociale, u vlerësua se ato përmbanin informacion të bollshëm dhe të përditësuar në mënyrë periodike.

Gjithsesi në një pjesë të tyre mungonin specifikimet me diagnoza (kjo e justifikuar me mungesën e mjekut psikiatër). Vazhdonin të mungonin të dhënat klinike dhe planet e drejtuara drejt qëllimeve klinike. Gjithsesi për të paraburgosurit e vlerësuar me probleme të shëndetit mendor ishin hapur PIT-e.

## **5. Shërbimet shëndetësore**

Në këtë I.E.V.P. sipas organikës për kujdesin shëndetësor punonin:

- 1 Përgjegjës sektori shëndetësor;
- 1 Mjek specialist;
- 1 stomatolog;
- 5 Ndhmës mjek;
- 1 Farmacist

Vendi i mjekut psikiatër ende nuk ekzistonte në organikë. Monitorimi u krye fillimisht në sektorin e paraburgimit ku gjendeshin 47 të paraburgosur. Në disa dhoma u konstatua mbipopullim gjë që detyronte që të paraburgosurit të flinin me dyshek në tokë duke favorizuar kështu sëmundje. Nga kontakti me të paraburgosur në dhoma të ndryshme u konstatua fakti i mungesës së medikamenteve, i vështirësive për sigurimin e tyre edhe në rastet kur i paraburgosuri ishte me librezë shëndetësore. Kjo vështirësi (sipas mjekes) lind nga fakti që për një numër medikamentesh nevojitet konsulta e specialistit që medikamenti të jepet i rimbursuar sipas skemës së marrëveshjes trepalëshe.

Pas kontaktit me të paraburgosurit nuk u konstatua që të kishte patur raste të neglizhencës apo moskujdesit shëndetësor nga ana e stafit të institucioni, dhe nuk kishte në të vërtetë raste mjekësore të pazgjidhura. Ekspertët kontaktuan me tre të sëmurë mendorë (në bazë të konsultave të kryera në QSB), por që ishin pa mjekim për preferencë të tyre. Një i sëmurë me astmë bronkiale (G.J.M.) trajtohej me medikamente në formë aërozoli dhe kishte vështirësi në

sigurimin e tyre, sidomos të medikamentit të parimbursueshëm. Ky i paraburgosur kishte trajtim të veçantë për orë shtesë për ajrosje, procedurë e cila duhej të zbatohet me rigorozitet.

Nuk u konstatuan dhe nuk kishte persona që të kishin probleme me abuzimin me substanca. Monitorimi vazhdoi më pas në pjesën spitalore të kësaj I.E.V.P.-je. Ekspertët theksojnë konstatimet e këtij viti për këtë aspekt mbeten po ato të një viti më parë. Infrastruktura mjekësore, dhoma e mjekut, dentistit, farmacia, dhomat e të sëmurëve ishin të mira, por mirëmbajtja dhe higjiena e tyre linte për të dëshiruar. Mungesa kishte edhe në mjetet mjekësore. Kishin në dispozicion një autoambulancë të re në gjëndje mjaft të mirë. Përmirësim për këtë vit mund jetë fakti që stomatologu punonte pavarësisht mungesës së materialeve, gjë e cila nuk kishte qenë e tillë në monitorimin e kaluar.

U monitorua farmacia, e cila ishte në kushte mjaft të mira të mbajtjes së medikamenteve, por konstatohet mungesë e tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit (kartelave mjekësore të të paraburgosurve që e dhanë pëlqimin për një gjë të tillë), u konstatua se në përgjithësi ato ishin të mirëplotësuar dhe me ndjekje në dinamikë kur i paraburgosuri apo i denuari kishte patur probleme shëndetësore. Pas monitorimit ekspertët ritakuan Drejtorin dhe një pjesë të stafit të kësaj I.E.V.P.-je dhe konstatimet e tyre në pjesën më të madhe morën vlerësimin e duhur prej tyre.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të Nenit 74/1 pika “b” të Ligjit Nr. 9888 dt. 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8328 dt. 16.04.1998 Për të drejtat dhe trajtimin e të dënurave me burgim”* ku parashikohet midis të tjerash se: *“Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:*

*b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohet trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor dhe poshtëruar”.*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave për ndarjen e të rriturve nga ata të grup-moshës 18-21 vjeçare, duke shmangur kështu bashkëjetesën e një të paraburgosuri të rritur me një 18-21 vjeçar (brenda sektorit të paraburgimit);
2. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e furrtareve ekzistuese në dhomat e të burgosurve/paraburgosurve duke intensifikuar periudhën e dizinfektimit të tyre;

3. Të merren masat për furnizimi me energji elektrike dhe ujë të rrjedhshëm në mënyrë të vazhdueshme;
4. Të merren masat e nevojshme për të ulur mbipopullim dhe për të garantuar një shpërndarje të drejte të të paraburgosurve në dhoma banimi në respekt të standardit të sipërfaqes së banimit për person.
5. Të marren masat e menjëhershme për sigurimin me shtretër, karrige dhe dollape të dhomave për çdo të paraburgosur;
6. Të merren masa të menjëhershme për të siguruar kohën e nevojshme për ajrim në përputhje me përshkrimet e mjekut;
7. Të merren masa për nisjen sa më shpejt të procesit të vënies në punë të dusheve me ujë të ngrohtë;
8. Rregullimi dhe vënia në përdorim të sistemit të ngrohjes për muajt e ftohtë të vitit;
9. Të merren masa për krijimin e një ambienteti të përshtashëm në rastet e takimit të të burgosurve/ paraburgosurve me familjarë të mitur;
10. Të merren masa për të mbajtur aktive kurset e arsimit dhe ato profesionale;
11. Të merren masa e nevojshme nga personeli përgjegjës për të mundësuar këshillime individuale e në grup në dhoma të planifikuara për këshillim;
12. Të plotësohen dosjet psiko-sociale me të dhëna klinike të dekursit dhe plane të drejtuara drejt qëllimeve klinike;
13. Të bëhen përpjekje për një mirëmbajtje dhe higjenë më të mirë të ambienteve spitalore, ambienteve të përbashkëta, si edhe të një numri të madh dhomash të të burgosurve/paraburgosurve si mjet kryesor për një shëndet të mirë fizik e mendor;
14. Të bëhet sa më parë të jetë e mundur furnizimi me medikamente, në mënyrë të veçantë të medikamenteve të urgjencës mjekësore, si edhe të materialeve dentare;
15. Në pamundësi të pajisjes së institucionit me një mjek psikiatër, të shikohet mundësia e pasjes në dispozicion të një mjeku psikiatër të zonës për të kryer vlerësime psikiatrike më të shpeshta dhe më të shumta në numër.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**



